



## **Procesverbal nga mbledhja e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve**

### **Nr. 13**

Datë: 15. 05. 2017, ora: 09:30

Vendi: Selia e KQZ-së/Prishtinë

Kryesuese e mbledhjes: Valdete Daka, kryetare e KQZ-së

Në mbledhje morën pjesë anëtarët e KQZ: Betim Gjoshi, Sami Hamiti, Ilir Gashi, Adnan Rrustemi, Binak Vishaj, Eshref Vishi, Nenad Rikallo, Ercan Spat, Bajram Ljatifi, Ergit Qeli.

SKQZ: Enis Halimi, Krye shef i SKQZ. Miradije Mavriqi, drejtoreshë e ZRPPC. Përkthyes: Vera Dula.

Procesmbajtës: Fehmi Ajvazi (ZLKMP).

---

## **RENDI I DITËS**

### **1. Hyrje: znj. Valdete Daka, Kryesuese e mbledhjes së KQZ-së;**

- *Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes të KQZ-së nr.08/09/10 dhe 11/2017;*

### **2. Aktivitetet e Sekretariatit lidhur me procesin zgjedhor;**

### **3. Aktivitetet e ZRPP-së**

- *Shqyrtim i rekomandimit për iniciativën politike "PARTIJA KOSOVSKE SRBA-PKS";*

### **3. Shqyrtimi dhe miratimi i kufizimeve të shpenzimeve të fushatës për subjektet politike**

### **5. Të ndryshme**

---

### **1. Hyrje: znj. Valdete Daka, Kryesuese e mbledhjes së KQZ-së**

**Valdete Daka:** Mirëmengjesi të gjithëve! Mrië se keni ardhë në mbledhjen e 13, të KQZ-së. E keni rendin e ditës para jush, të gjithë....A ka dikush vërejte, plotësim, në këtë rend dite?

**Betim Gjoshi:** Ndoshta, se di a ia vlenë si pikë e rendit të ditës, por sot fillon regjistrimi si aktivitet i votuesve jashtë vendit. Ndoshta, ka qenë mirë me e diskutuar. Besoj, është mirë me ftuar shërbimin votues me na dhënë disa informacione se, si është mbarëvajtja e tij dhe, cilat janë masat e mbrojtjes së këtij procesi ?

**Valdete Daka:** Pajtohem plotësisht, se është proces i rëndësishëm , edhe se di sa pajtohen të tjerët...Po, si pikë e rendit të ditës e vlen, e thirrni edhe zyrtarin e KQZ-së i cili, është me siguri prezent.

Atëherë, kush është për këtë rend dite me këtë pikë shtesë...?

*Anëtarët e KQZ-së, miratuan rendin e ditës.*

#### Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes të KQZ-së nr.08/09/10 dhe 11/2017

**Valdete Daka:** Vazhdojmë me pikën e parë: Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjeve nr. 08,09, 10 dhe 11 të këtij viti. A ka dikush vërejtje në këto procesverbale...? Nëse jo, kush është për miratimin e tyre.

*Anëtarët e KQZ-së, miratuan këto procesverbale*

## **2. Aktivitetet e Sekretariatit lidhur me procesin zgjedhor**

**Enis Halimi:** Sekretariati i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, ka vijuar me angazhimin e tij me qëllim të përmbushjes së detyrave dhe të obligimeve, komform planit operacional dhe komform obligimeve që dalin nga rregullativa përkatëse. Bazuar në planin operacional për zgjedhjet e parakoshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës që, do të mbahen me 11 qershor 2017, Divizioni i Shërbimit Votues më datën 12 maj, ka pranuar ekstraktin e parë nga Regjistri Qendror Civil, pra ekstraktin e parë të regjistrimit qendror civil nga Agjensioni për Regjistrim Civil, që përmban personat mbi moshën 18 vjeçare, pra, ata që kanë të drejtë që të votojnë, dhe ata që i bëjnë, apo mbushin moshën 18 vjeçare në ditën e zgjedhjeve.

Po ashtu, tha z. Halimi, pas pranimit të këtij ekstrakti, është duke u bërë caktimi i votuesve për ndarjen e votuesve, përkatësisht, nëpër qendrat e votimit. Sa i përket numrit total të votuesve, tash numri i tyre është 1.885.147 votues. Për sa i takon dimensionit të votimit jashtë Kosovës, pra si fazë komform planit operacional, fillon sot, më 15 maj dhe përfundon me datën 22 maj. Divizioni shqyrtues, është duke u bërë përgatitjet të këtyre aplikacioneve për regjistrim të të gjithë votuesve të suksesshem që kanë aplikuar për të votuar në zgjedhjet parlamentare të viti 2014. Numri me pako i aplikacioneve, sillet rreth 16.765 dhe gjithashtu, në funksion të periudhës për regjistrim janë të publikuar për informata dhe udhëzimet e nevojshme dhe po ashtu, duke u bërë një informim publik në mediumin public, komform procedurave të parapara. Gjithashtu, sekretariati gjatë kësaj periudhe, ka zhvilluar një mori aktivitete që lidhen me procese, qoftë operacionale dhe, qoftë buxhetore dhe të prokurorisë. I keni në material, numrin e këtyre aktiviteteve që janë të karakterit etnik. Besoj së shpejti se, edhe buxheti od të na

alokohet që të mund të procedojmë efektivisht në kuptim të përmbushjes së obligimeve ligjore: edhe për t'u futë në marrëdhënie kontraktuale, qoftë edhe në natyrë operationale, dhe blerjes së materialeve. Besojmë, sado që koha nuk punon në anën tonë kësaj radhe, pra kohën e kemi armikun kryesor por, ne besojmë që me një punë të këtillë të Sektorit, do të arrihet që ne do t'i përmbushim të gjitha obligimet, por me kusht që buxheti të alokohet në mënyrë që ne të procedojmë me aktivitetet e parapara të këtij procesi zgjedhor të jashtëzakonshëm.

**Valdete Daka:** Faliminderit, dhe ja një lajm i mirë... Sapo, u zotuan mjetet për buxhetin, pra u aprovua buxheti për këto zgjedhje nga Qeveria kështu që, nuk do e kemi problem...A ka dikush diçka për kryeshefin lidhur me i ndihmu nëse duam, mujmë me i ndërlidhë këtë pikën e votimi jashtë Kosovës me infomatën që na e japi kryeshefi si pikë të veçantë... mirë, vazhdojmë me aktivitetet e ZRPP-së...

### **3. Shqyrtim i rekomandimit për iniciativën politike "PARTIJA KOSOVSKE SRBA-PAKS";**

**Miradije Mavriqi:** Faliminderit kryetare...Zyra ka pranuar për kërkesë për regjistrim për një iniciativë "PARTIJA KOSOVSKE SRBA – PAKS". Zyra, e ka kontrolluar dokumentacionin, i tërë materiali, dhe gjithashtu është bërë edhe shpallja publike për shqyrtim në media dhe në faqen zyrtare të internetit. Në periudhën 7 ditore, zyra nuk ka marrë ndonjë kundërshtim në lidhje me regjistrimin e kësaj partie politike. Prandaj, zyra rekomandon për regjistrim, konform të gjitha ligjeve në fuqi.

**Binak Vishaj:** Është e njëjta parti politik që edhe në mbledhjen e kalimeve ka pasur një rekomandim për me u regjistruar...Kan qen edhe rekomandim i juaj...Dy elemente kanë qen që na kanë shtyrë që na me kerkue që ata t'i ndryshojnë në rast se ata dojnë të regjistrohen...Per emër po e shoh se e kanë ndryshu, por du me e pa edhe simbolin... Cili, është simboli i këtij subjekti politik?

**Miradije Mavriqi:** E keni pas edhe në shkresë zyrtare, ja, ky është simboli.

**Betim Gjoshi:** E para, sa i përketë numrit të pjesëmarrësve këtu, jemi pak, është mirë që secili këtu me u deklaruar para se të hudhet në votim...Nëse nuk ka vota të mjaftueshme është mirë të mos shkohet në votim...Kjo, i don 2/3 d.mth., ose të tërë nga të gjithë anëtarët... E dyta, sa i përketë vërejtjeve, mua më vjen shumë mirë që kjo parti politike i ka respektuar rekomandimet e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, dhe e ka ndërruar emrin, dhe e ka ndryshuar logon...

Mbi të gjitha, tha z. Gjoshi, unë kam pa zotimet e saja brenda statutit që ajo njeh rregullat dhe ligjet e Republikës së Kosovës, që kjo është shumë me rëndësi edhe për integrimin e kësaj pjese të komunitetit në Kosovë...Ne, i dimë problematikat që kemi pas në zgjedhjet e kalimeve, po ajo që unë ndoshta kisha dashur të bëj një pyetje për zyrën, lidhet me atë se, mbi që unë nuk jom njohës i mirë i gjuhës serbe, kisha dashur me ditë se emri i saj, a mos tingëllon si ma shumë se i partive tjera, d.mth., me sa pe kuptoj unë, kjo ka tentu m'u regjistruar si partija e serbëve të Kosovës. Por, ne kemi edhe parti të tjera tash..., a mujm me ja lon dikujna autorizimin deri në këtë masë...Me pas qen Partija Serbe ish kon ok, por partija e Serbëve të Kosovës...,mos është pretendim i tepërt..., mos mun me i dhon naj favor kësaj partije ne

zgjedhje, per ndryshe, unë do ta mbështes në qofë se kam shpjegime të mjaftueshme për sa i përketë emrit prej zyrës...

**Miradije Mariqi:** Gjatë kontrollimit të këtij dokumentacioni, ne sigurisht që jemi konsultu edhe me nenet e ligjit, legjislacionit që kemi...Zyra, nuk ka pa ndonje prioritet që kishte me ndodh apo, ndonjë diçka si emër i veçantë, sepse nuk është iritues, nuk përfaqëson diçka emri qe kish me simbolizuar kundër ndonjë partië tjetër apo, kundër ndonjë individi kështu që zyra, është bazuar në ato nene të ligjit...

**Nenad Rikallo:** Është mirë që të kemi në jetën politike sa më shumë parti dhe sa më shumë persona që duan të marrin pjesë në pluralizimin politik, dhe jeta politike dhe sociale të jet ëmë e mirë. Ajo që më brengosë, ky subjekt e ka ndryshuar emrin dhe llogon mirëpo, në statut nuk kan ndryshuar dhe 26 dhe 42 janë në kundërshtim me ligjin. Është fjala se ata vendosin për mandatet e deputetëve që është në kundërshtim me ligjin për zgjedhjet në 6 nene...Në status, kanë ndryshuar emërtimet në fq. 13, dhe arsyeja për refuzim është e dukshem...Unë nuk mund ta votojë, dhe jam kudnër...

**Ilir Gashi:** Pasi që u kërkua që të deklarohemi rreth asaj se, si do të votohet për shkak qe kërkohen 2/3...Mendoj që, asnjë aptri nuk mund të regjistrohet nëse bje ndesh me ligjin...E mira, është se kjo parti po regjistrohet në përputhshmëri me ligjet e Republikës së Kosovës, dhe ka marrë parasysh rekomandimet tona si instucion, ka bërë ndryshimet e nevojshme kështu që unë, jam pro që të miratohet duke qen ne të vetëdijshëm në vazhdimsi se, do të përcjellim se, sa do të jenë të zbatueshme këto programe, këto statute të partive politike...

**Ercan Spat:** Faleminderit kryetare...Mua personalisht, më pëlqen se si, një parti e komunitetit pakicë në emrin e vet e përmend Kosovën, dhe deklarohet si partia kosovare çka e karakterizon edhe shumicën e partive të Kosovës. Nëse ekzistojnë çfarëdo mos përputhje apo gabime teknike të cilat edhe si kemi vërejtë apo, ndoshta edhe i ka vërejtur dikush prej kolegëve, unë mendoj se na mundemi në të vërtet, ky edhe është propozimi jem konkret: t'i japim një afat për përmirësime nese eventualisht, ka gabime teknike të cillat nuk janë përmirësuar, e mos të humbim kohë ma me këto aktivitete duke e ditur edhe se çka na pret, me çka po mirremi...

**Binak Vishaj:** Tashti, mbasi është për t'u deklaruar, unë jam për kështu që Komisioni Qendror Zgjedhor mundet me procesu, rekomandimet janë plotësuar nga kjo parti politike ...Ndoshta, mundet që në tekstin e mëhershëm me figuruar emri propozimit të mëhershëm i subjektiti, por emërtimi i vjetër mundet me u eliminuar...por, ky është difekt teknik dhe nuk paraqet pengesë...Kështu që, unë jam për dhe, votoj për regjistrimin e keti subjekti politik.

**Eshref Vishi:** Faleminderit...! Konsideroj se aplikimi për regjistrimi I subjekteve politike në Kosovë, duhet t ëjet ënë përputhje me rregullat dhe me ligjet për aplikim për regjistrimit të aptive politike. ZRPP, konsideroj se i ka pasur parasysh këto çështje, gjatë shqyrtimit të apliakcionit. Megjithatë, unë kërktoj edhe njëherë mendimin e ZRPP lidhur me shqetësimet e ngritura rreth përmbajtjes së statutit. Konsideroj se nuk janë shumë thelbësore problemet teknike, se sa ato përmbajtësore...Ndoshta, zyra e ka mendimin e vet...

**Miradije Mavriqi:** Partia politike në momentin që regjistrohet, e ka një afat gjashëtmujorë që ta mbaj kuvendin zgjedhor, dhe t'i legjitimojë të gjitha organet e saj...Në momentin që dorëzohet dokumenti në zyre, zyra e kontrollon dhe nëse ka ndonjë problem, i kthehet mbrapa...

**Binak Vishaj:** Duhet ti shohejmë të dy versionet...Nëse ka problem në versionin në gjuhën serbe, në gjuhën shqipe është në rregull...E hedhim në votim sepse, edhe jemi në procesin zgjedhor dhe nuk mund ta shtyjmë që disa herë...

**Nenad Rikallo:** Në të dy gjuhët është identik dhe, i përkthyer është po ashtu...dhe nuk ka dallime.. E kam analizuar dhe versionet janë të njëjta...

**Sami Hamiti:** Gabimet që po dalin tani, e që janë edhe të subjektit paraprak që e kemi votuar, kanë egjistuar mangësi të vogla. Këtë rast, kërkesa që ka qenë nga mbledja paraprake që ishte për vërejtjet që i dha komisioni, shumica absolute, esencialisht janë ndryshuar. Tash, në këtë rast, duhet të marrim dëgjime... Po e shoh zotin Rikallo, por tash, është pak specifike kjo punë sepse, dhe se po kundërshton... Realisht, mendoj që, në këtë rast, një subjekt që ka ardhë me u regjistruar dhe u nënshtrohet ligjeve dhe kushtetutës së Republikës së Kosovës...Në nenin e parë, konsideroj që edhe në përmbajtje edhe në formën qysh është regjistruar duhet të pranohet. Tash, mos t'marrim, faktikisht, fije-fije dhe mos me e regjistruar një subjekt, me mbetë... KQZ-ja, që në momentin fundit e zhagitë dhe, nuk e regjistron një subjekt politik... Por, une jam për!

**Valdete Daka:** Mirë, faleminderit! Atëherë, po e qesim në votim. Kush është për regjistrimin e këtij subjekti politik? Kush është kundër...? Ateherë, mund të konsiderojmë që është regjistruar...

Anëtarët e KQZ-së, miratuan rekomandimin për iniciativën politike "PARTIJA KOSOVSKE SRBA-PS", me një votë kundër (Nenad Rikallo)

#### **4. Shqyrtimi dhe miratimi i kufizimeve të shpenzimeve të fushatës për subjektet politike**

**Miradije Mavriqi:** Duke u bazuar në nenin 3.1 dhe 3.3 të Rregullës zgjedhore nr. 12/2013, për kufizimin e shpenzimeve të fushatës dhe deklarimin financiar, zyra ka përgatitur draftvendimin për zgjedhjet që do të mbahen më 11 qershor të këtij viti. Shuma, është, në bazë të zotuesve ose në bazë të regjistrit civil që na është dorëzuar për votuesit e regjistruar të cilët, janë 1 885 147 votues të regjistruar, dhe në bazë të legjislacionit në fuqi. Për një votues, llogaritet 0.50 cent dhe shuma, ose shuma e limituar për subjektet politike për shpenzim të fushatës, është 942 573.50 euro.

**Betim Gjoshi:** Ndoshta, çka është mirë me u saqurë, është mirë se KQZ, nuk jep asnjë lloj fondi për fushatë zgjedhore. Shifra që përmendi drejtoresha, është limiti, ku më së shumti një subjekt politik mundet me shpenzuar në këtë fushatë zgjedhore, t'u u bazu në burime të ligjshme, që i lejon ligji për financimin e subjekteve politike. Pra, na nuk japim, s'e në zgjedhjet e kaluara kemi pas kërkesa, m'a tutje..., s'e kanë mendu se ne u ndajmë një fond partive politike. Pra, fondet për zhvillim të partive politike, ndahen pas perfundimit të zgjedhjeve në baze të numrit të deputeteve, por për ato që garojnë nuk ka një fond për mbulim të shpenzimeve të fushatës. Ky, është veç një kufizim i shumës monetare,

t'u përfshi edhe në shërbime dhe në mallra edhe në të gjitha llojet e mundësive që ka me shpenzu një subjekt. Maksimalja, është shuma që permendi zyra për regjistrim të partive politike.

**Valdete Daka:** Në qaftë se jam e saktë, 942 753 euro është shuma më e lartë të cilën një subjekt mundet me e shpenzu për fushatë zgjedhore, për këto zgjedhje. Atëhere, kush është për?

Anëtarët e KQZ-së, miratuan kufizimet e shpenzimeve të fushatës për subjektet politike

**Valde Daka:** Vazhdojmë me pikën tjetër, e kjo pikë është një raport i shkurtër me shërbimin e votuesve jashtë Kosovës. Besniku, është këtu...

**Besnik Buzhala,** Departamenti i Listes Votuese: Përshendetje gjithvë...Periudha e regjistrimit për votim jasht vendit, fillon sot më datën 15 dhe do të përfundoj, me datën 22 Maj 2017. Në lidhje me përgaditjen e periudhes për regjistrim, i kemi publikuar pikat shpërndarse që jan diku, 169. Në këto pika shpërndarse, bëjnë pjesë edhe ambasadat dhe konsullatat e Republikës së Kosovës, dhe personat kontaktues të subjekteve politike që, janë të regjistruara në Republikën e Kosovës. Deri tash kur po flasim, diku na kan ardhur 100 kërkesa për aplikime të cillat, do të thotë kemi fillu me i procesue edhe njejtën kohë, me i njoftu votuesit për statusin e tyre të aplikimit. Do të thotë, ne para kësaj faze, ne gjithashtu kemi përgatitë materialet për 16,755 aplikus të sukseshëm të zgjedhjeve të fundit të vitit 2014, ngase, sipas rregulles zgjedhore do të thotë, të gjith votuesit e sukseshëm kan aplikuar në zgjedhjet e fundit, drejt për drejt përmes postës, kështu që deri në këtë fazë jane rreth 100 kerkesa për aplikim të cilat janë duke u procesuar.

**Valdete Daka:** Faleminderit Besnik. A ka dikush pyetje për Besnikun...?

Betim Gjoshi: Kryetare, unë e përgëzoj shrbimin votues, t'u u bazuar në kohën e limitume që ka, ka marrë gjitha masat me u përgjegj votimet jashtë vendit, duke përfshi edhe votuesve që kane qenë ma heret se, e kan statusin e të regjistruarit tash. I inkurajoj në punen e vet, ndoshta unë si antar i Komisionit Qendror Zgjedhor me qëllim, jo veç tonin po edhe opinjonit publik , ndoshta kish mujt me na tregu se cilat janë mastat - mjetet që ka marr që ky proces me qenë sa ma legjitim, e që mos me na ndodh me segmente të caktume m'u komprementue etj. Pra, qysh veprohet me regjistrimin , cilat janë mënyrat, masat që mos me përdorë në emër tjetër kujt me këtë proces, edhe mandej edhe për pjesen që na e kem pas ma problematike në zgjedhjet e kaluara për votimin nga Serbia dhe Mali i Zi...

**Besnik Buzhala:** Ne, do të thotë gjatë procesimit të aplikacioneve, kujdesemi në masë të madhe ti shqyrtojmë aplikacionet në aspektin për me vërtetu që aplikacionet janë..., ose a kemi aplikacione që janë të nenshkrume prej një personi. Ne, këto i shiqojmë me nje kujdes të veçantë, i trajtojmë me kujdes të veçantë...Kriteret edhe për vlersimin e zotësisë juridike, i shikojmë edhe në përputhje me ligjin dhe me rregullat që janë në fuqi...

**Binak Vishaj:** Pasi që sot fillon shqyrtimi i aplikacioneve për regjistrim, njona pi mundësive është edhe aplikimi përmes e-mailit për t'u regjistruar si votues i rregullt. Unë, kisha pas si propozim me qitë, se një aplikant mund të aplikoj vetëm për familjen e vet...Në rast se është një adresë e njejtë, jashtë çdo

adrese, nuk mundet me apliku për shkak se ka tendencë edhe mundet me ju jep mundsia që dikush në emër të dukujt tjetër, pa vullnetin dhe pa miratimin e dukujt tjetër, me apliku për regjistrim, do të thotë me pa pasi jemi në këtë fazë të shqyrtimit se aplikacionet që vijnë me email, e që janë më shumë, dhe jo familjar dhe jo me adresën e njejtë...Për vleresim timin, nuk është mirë me u trajtu si aplikacione, sepse kam dyshme se dikush i bën pa vullnetin e atyre personave për të cilët u bë kërkesa....

**Adnan Rrustemi:** Në radhë të parë, duhet ta shohim këtë aktivitetin e votimit jashtë vendit si një nga mundesitë për me i përfshi mërgatën në proces zgjedhor, si një nga të drejtat që ua garanton kushtetuta dhe ligji, natyrisht.... Dhe si KQZ, brenda përgjegjesive tona, brenda infrastrukturës ligjore që kemi, të shohim çfarë veprime mundemi me ba, për me e lehtësu këtë proces. Ne, e dimë që jemi në proces të jashtëzakonshëm, i kemi 30 ditë kohe për komplet procesin. Ne, i kemi vetem 8 dite kohë për regjistrim të votuesve jashtë vendit. Kjo, nënkupton, nëse dojmë si institucion të paktën, pra, sa është e mundur me i përfshi votuesit e mërgatës në proces, të bëhen veprimet të cilat janë më efikasat në këtë fazë. Duhet të jemi, kështu, qartazi, nëse, po e zë, mendohet e të nxitet dhe të shtyhet edhe si informim publik regjistrimi i votuesve, përmes postës, e kam fjalën përmes dërgesave postare. Ne, duhet ta themi që këtu, që kjo është e pamundur..., nuk mundet asnjë votues, thajse, me u regjistru duke dërgu dërgesë postare nga sot, deri më 22 maj, që është perioda e përfundimit të regjistrimit. Kjo, na bën të qartë që mbesin 2 mundesi me efikase të regjistrimit, dhe duhet edhe si informim publik me i dhënë prioritet këtyre... Nuk po them mos me theksue edhe regjistrimin përmes dërgesave postare, por edhe me regjistrimin përmes emailit dhe përmes faksit....

Unë, tha z. Rrustemi, pajtohem me atë që e tha Binaku, madje unë mendoj që është mirë me i përdorë, se ne ende s'kemi filluar me prodhë asgjë mediatikisht, ç'është e vërteta! Por, me përdorë rrjetet sociale, facebook-un, në KQZ me ba njoftim që, aplikacionet është mirë që secili t'i dërgoj nga emaili i tij, por e shumta nga familja e ngushtë, dmth, mund të dërgohen me një email adresë... Adresat, i plotëson në formular. Adresa ku jeton votuesi për KQZ-n, e ka vetëm një rëndësi, për me e ditë ku me ia dërgu fletevotimin. Kjo, është e rëndësishme për KQZ-n. Ne, duhet ta bëjmë një njoftim, si shpejtë te sekretariati, në facebook, s'paku, ose e lëshoni një njoftim kudo qoftë në ëebfaqe, apo në facebook. E dyta, ne duhet të marrim rol stimulus në këtë fazë, sepse koha është e shkurtër, nuk pritët që do të kemi mundësi të pjesëmarrjes së dijnitetshme, por megjithatë me ba punën tonë duhet...Nuk e di a ka bërë sekretariati ndonje, s'e na e dimë që kemi një memorandum të bashkpunimit me Ministrinë e Diaspores për këtë është. E kemi miratuar para disa muajve, nuk ka me tepër, dhe nuk e di a është vu në funksion ky memorandum. Çarë veprimi ka marrë Ministria e Diaspores? A ka bërë ndonjë njoftim? A i ka njoftuar këto qendrat e shoqatat kulturore që i ka pas në listë? A ka marrë ndonjë veprim në drejtim të informimit të mërgatës për me marrë pjesë në zgjedhje? E ka fushëveprim të ministries, ekskluzivitet për me u interesue për të drejtat dhe interes e diasporës në përgjithësi. E dyta, nuk e di a ka ndonjë ndërveprim me Ministrinë e Jashtë, respektivisht me ambasadat dhe konsulatat?! A kanë filluar me ba ndonjë njoftim, ose me komunikuar me mërgatën?

Është koha shumë e shkurtër, tha z. Rrustemi, nëse në këto 8 ditë nga sot, nuk e dëshmojnë një rol aktiv të gjitha institucionet, dmth, nuk mund të presim ndonjë rezultat në këtë drejtim. Ndërkohë, pajtohem me atë që, ne të respektojme ligjin për gjithë votuesit jashtë vendit në mënyrë të njejtë! Të përkujdesemi që mos të kemi as diskriminim, por të kemi kujdes me profesionalizëm për

gjithëpërfshirje, duke i respektuar kriteret e zotësisë juridike, që i kemi miratuar si KQZ në kuptimin se, kush ka të drejtë vote, masat e sigurisë e kështu me radhë... Me qenë goxha profesional në kthimin e përgjigjeve ndaj votuesve, sepse po bën ata pyetje, pastaj, sepse vihet në pyetje edhe integriteti i KQZ-së e kjo është me rëndësi, e kështu me radhë...

**Betim Gjoshi:** Kryetare, për më të mirë renditë radhazi edhe unë e përkrahi atë që propozoj Binaku. Për me e ruajt integritetin, është mirë që me u mendue që është qendrim dhe vendim i gjithë KQZ-së, dhe për këtë edhe duhet me lëshu një komunikatë... Tash, që edhe mediat po i japin hapsirë dhe rëndësi. E falenderoj KQZ-në, e para e punës, e dyta, unë mendoj që jo na, por ligji i trajton në mënyrë të njejtë votuesit... E treta, shërbimi votues dhe kryeshefi në këtë rast, për mos me ia lanë krejt barrën shërbimit votues dhe departamenteve të operacioneve zgjedhore, është mirë me ba kontakt me postën që me i përshpejtuar këto çështjet e komunikimeve me diasporën... E katërta, është mirë me e rritë bashkëpunimin me Ministrinë e Diasporës dhe të Punëve të Jashtme, dhe këto pikat e tjera kontaktuese që ky process, me u mbarëvajtë sa më mirë. Ne, jemi mes dy qëllimeve: I pari qëllim, është që me i mundësue atyre që kanë të drejtë vote në bazë të ligjit, që në këtë rast, janë diaspora dhe dyti, me e ruajtë integritetin e zgjedhjeve. Mes të dyjave, se ne nuk e kemi caktuar këtë afat të shkurtër zgjedhor, e ka caktuar ligji, dhe nuk kemi faj këtu përbrenda, por duhet me ba maksimalen, dhe po besoj që edhe shërbimi përkatës është t'u e ba maksimalen dhe për këtë, unë edhe njëherë i falenderoj, dhe jam mbështetës i të gjitha masave që ata mendojnë që munden me i kontribue procesit të integritetit në këtë fushë, përveç atyre që ne si KQZ, i kemi propozuar...

**Nenad Rikallo:** Absolutisht, pajtohem me anëtarët që thanë se të gjitha aktivitetet që i ndërmarrim, duhet që të t'ua mundësojnë të gjithëve atyre që kanë të drejtë në votë, të munden të votojnë...Pra, të gjithë ata që janë jstë Kosovës, të ken mundësi që ta realizojnë të drejtën e tyre të votimit... Sigura e votës, duhet të jetë në nivelin më të lartë, dhe kjo siguri në asnjë mënyrë nuk duhet të vihet në pikëpyetje...

Gjithëçka që është në mundësitë tona, në aktivitetet tona të ndërmirret, dhe unë pajtohem që ne dueht t'ua bëjmë sa më të lehtë votuesve tanë mundësinë e votimit...Ajo që dua t a vëjë në vëmendje, është që Sekretariati, t'i kushtoj vëmendje asaj që në zgjedhjet e kaluara, njerëzit që kanë sjellë kërkesat e tyre në alfabetin çirilicë, nuk kanë mundur të lexohen, disa janë refuzuar etj., kështu që ju lutem t'i kushtoni kujdes kësaj...

**Enis Halimi:** Ne, do të fillojmë nga kjo e fundit, që të punësojmë stafin që na ndihmon në këtë situatë, qoftë me alfabetin cirilik, qoftë tjetër. Për shkak të eliminimit të çdo barriere gjuhësore dhe teknike që do të shpiente në rezultate negative. Për sa u takon kontakteve me postën, ne edhe më herët kemi qenë në marrëdhënie edhe kontraktuale me ta, por edhe në takime, në menyrë që të bisdojmë për ta vënë në prioritet çështjen e këtij operacioni zgjedhor. Ndërkaq, sa i takon Ministrisë së Diaspores, ju e dini, memorandumit me Ministrinë e Diaspores, ende nuk është nënshkruar. Kemi provuar në 2016 që ta nënshkruajmë, edhe në 2017, dhe kemi hasë në një neglizhencë të pakundshoq të strukturave, qoftë administrative, qoftë politike të tyre për ta nënshkruar këtë memorandum. Pra, memorandum si i tillë,



nuk ekziston i formalizuar. Nga ana jonë, ka qenë qysh në vitin 2016, pra para një viti! Ndërkaq, Ministria e Diasporës, edhe njëherë po them, ka manifestuar neglizhence të paparë...

**Valdete Daka:** E patëm një çeshtje... Të fillojme me rend. Atëhere, çëshjta e parë është se me një email, t'i mundësohet aplikimi për regjistrim, vetëm atyre që janë në një adresë të banimit dhe me një mbiemër, pra në një familje. Nëse mund të konkludojme kështu, si vendim të KQZ-së, a duhet të votojmë, pra formalisht? Ligji është i qartë...

**Adnan Rrustemi:** Ne, mundemi me i dhanë disa udhezime, madje këtu ish dashtë me i nënkuptuar dhe me i zbatue sekretariati, por po më duket që, duke pas parasyshë kontekstin... Unë, pajtohem që nga e njëjta familje me mujtë me i dërguar nga i njejt i imell aplikacionet, por adersën e banesës munden mos me e pas tq njqjtq anëtarët e familjes së ngushtë... Janë raste të rralla, fletëvotimi shkon me postë, sepse nuk mundet me e dërguar as me imell, dhe as me faks...Mua, po më duket e pazbatueshme që me e shikue adresen në nivel të pranimit ose jo, sepse e vlerësimit është tjetër...Kjo, shkakton konfuzitet... Unë, tha z. Rrustemi, mendoj që kështu duhet me e bërë përkufizimin: *"Njoftohen qytetarët ose bashkëatdhetarët, votuesit jashtë vendit që, aplikimin për t'u regjistruar si votues jashtë vendit, ata që regjistrohen përmes imellit, regjistrimin mundësisht ta bëjë secili përmes imellit të tij. Në rastet e veçanta, janë të pranueshme nga familja e ngushtë...!"*

**Valdete Daka:** E përsëris se, të gjithë votuesit nga dispora do të kenë trajtim të njejtë, pra nuk do të kenë trajtim të ndryshëm...Pra, do të pranohen vetëm aplikacionet që vijnë në mënyrë të paraparë me ligj, dhe fletëvotimet që vijnë me postë, ashtu siç e parasheh ligji...Të gjithë, do të njoftohen përmes ueb faqes sonë, dhe përmes pikave shpërndarëse...

## **5. Të ndryshme**

Nuk ka pasur asnjë pikë për shqyrtim.

---

**Për KQZ**

**Valdete Daka, kryetare**

-----